



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM
Nr. 275, Datë 17.12.2020

PËR MIRATIMIN E VEPRIMTARISË JASHTË FUNKSIONIT

Në mbështetje të nenit 149/ç, të Kushtetutës të Republikës të Shqipërisë, nenit 9, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 189/1/a, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenit 8, të Rregullores së KLP-së “Për veprimtaritë jashtë funksionit të prokurorëve”, pasi u njoh me kërkesën me nr. Prot 1540, datë 30.10.2020 dhe Relacionin e përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e veprimtarisë jashtë funksionit (mësimdhënie) pranë Kolegjit Universitar “Bedër” Tiranë, si lektor me kohë të pjesshme, në masën 2 (dy) orë në javë, jashtë orarit të punës, në lëndën “Procedurë Penale e avancuar me praktikë gjyqësore”, për vitin akademik 2020-2021.
2. Të njoftohen për këtë vendim z. Adnan Xholi dhe Prokuroria e Përgjithshme.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETARI
GENT IBRAHIMI

ANËTAR
BUJAR SHESHI

ANËTARE
ESMERALDA KESHI

ZV/KRYETARI
ALFRED BALLA

ANËTAR
KOSTAQ BELURI

**ANËTAR
SANDËR BECI**



**ANËTARE
NURIHAN SEITI**



**ANËTAR
VATË STAKA**



**ANËTAR
TARTAR BAZAJ**

